

VENDIM
Nr. 869, datë 18.6.2008

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 7889, DATË 14.12.1994 “STATUSI I INVALIDIT”

(Ndryshuar me VKM nr. 1075, datë 23.7.2008; nr. 1235¹, datë 16.12.2009; nr. 38², datë 19.1.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personave përfitues, sipas përcaktimit të nenit 1 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, u jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, në masën:

a) 3300 (tre mijë e treqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga sëmundje të përgjithshme;

b) 2200 (dy mijë e dyqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga sëmundje të përgjithshme;

c) 4000 (katër mijë) lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;

ç) 2700 (dy mijë e shtatëqind) lekë në muaj, nëse janë invalidë të pjesshëm, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.

2. Invalidi do ta përfitojë shtesën për paaftësi, sipas përcaktimeve të dhëna në shkronjat “a”, “b”, “c” e “d” të pikës 1 të këtij vendimi, edhe kur del në pension pleqërie.

3. *Pagesa e përfitimit të paaftësisë, për invalidin, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njërive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.*

4. Efektet financiare shtesë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 97 000 000 (nëntëdhjetë e shtatë milionë) lekë të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2008, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. *Fondi 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë të përballohet nga fondi i kontingjencës dhe të derdhet në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.*

6. Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të nxjerrin udhëzim në zbatim të këtij vendimi, për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimet nr.381, datë 20.5.1996 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”” dhe nr.204, datë 16.4.2004 “Për masën dhe kriteret për përfitim paaftësie nga personat me statusin e invalidit të punës” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

¹ VKM nr. 1235, datë 16.12.2009 i shtrinë efektet nga data 1 janar 2010.

² VKM nr. 38, datë 19.1.2011 i shtrinë efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha